

URDHËR
Nr. 220, datë 29.5.2012

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA “MASTER PROFESIONAL” DHE
FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE PËR KËTO PROGRAME, PRANË
SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANËS”,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 911, datë 26.8.2009 “Për licencimin e shkollës së lartë private “Universiteti Planetar Tiranës””,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Shkencave të Zbatuara të Shkollës së Lartë Private “Universiteti Planetar i Tiranës”, Tiranë, dhe fillimin e veprimtarisë akademike për programet e reja të studimit të ciklit të dytë, që realizohen me 90 kredite, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në:

- a) Infermieri klinike;
- b) Infermieri pediatrie;
- c) Infermieri kirurgjikale;
- d) Infermieri geriatrike.

2. Këto programe studimi hapen në bazë të vendimit nr. 231, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Shkolla e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës” Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj